



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 70, datë 24.04.2025

PËR
***“CAKTIMIN E PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM VLORË”***

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 24.04.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores *“Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”*, shqyrtoi çështjen me objekt:

***“Caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së
Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”***

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacioni shoqërues nr. 1238 prot., datë 23.04.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin zotin Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Bazuar dhe në përputhje me nenin 149, pika 1, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli), është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

2. Me cilësinë e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, si dhe konform përcaktimeve ligjore të shprehur në nenin 44, "Zëvendës drejtuesi i prokurorisë", pika 4, të Ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, z. Arian Xhaferaj ka drejtuar zyrën në fjalë për një periudhë dy vjeçare dhe saktësisht deri në dt 31.10.2024.

3. Vakanca e krijuar në vazhdim, është superuar me vendim nr. 16 datë 30.01.2025 të Këshillit, duke caktuar përkohësisht prokurorin Erjon Shqarri në pozicionin e drejtuesit të kësaj zyre prokurorie, për periudhën 01.02.2025 deri më 30.04.2025.

Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se:

4. Në përfundim të këtij afati, pozicioni i drejtuesit të zyrës mbetet sërish vakant, ndërkohë që konsiderohet domosdoshmëri plotësimi i tij me qëllim garantimin e funksionimit të zyrës në fjalë, në përputhje edhe me përcaktimet ligjore të shprehura në Ligjin 97/2016, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 42, "Kompetencat e drejtuesit në drejtimin e prokurorisë".

5. Në këtë rast, Këshilli vlerëson të saktësojë se "caktimi i përkohshëm", përbën mekanizmin ligjor efektiv me qëllim plotësimin e vakancës eventuale, i cili legjitimohet të përdoret referuar:

- i. Neni 42, pika 2, "... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, **për të paktën 3 muaj**, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.", i ligjit Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- ii. Neni 59, pika 1, "Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të: caktimit në pozicione të tjera, arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji", i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- iii. Neni 3 "Kriteret për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", i Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" e ndryshuar, ku përcaktohet se:
"Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër".

7. Referuar dispozitave ligjore, dhe konkretisht neni 47 "Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë" të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe rregullatore shprehur në nenin 8 të Rregullores "Për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit", si dhe bazuar në faktin që



prokurori Erjon Shqarri ka mbi 8 vite vjetërsi si magjistrat dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi, Këshilli vlerëson se drejtimi i zyrës së prokurorisë Vlorë, të vijojë të kryhet nga i njëjti magjistrat.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149 pika 1, 149/a pika 1 germa "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 42 pika 2 dhe 59 të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2 dhe 6, 189 pika 1, germa "a" të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*" i ndryshuar, si dhe nenin 3 të Rregullores "*Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve*", e ndryshuar,

VENDOSI:

1. Caktimin e përkohshëm të prokurorit Erjon Shqarri në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për një periudhë tre mujore, duke filluar nga data 01.05.2025 deri në datë 30.07.2025.
2. Zoti Erjon Shqarri do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nga data 01.05.2025 deri në datë 30.07.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Erjon Shqarri, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 24.04.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Merkuri

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla

KOPJE WEB